

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dëbimi i pestë nga Britania, shqiptari kërkon azil: Në Shqipëri më rrezikohet jeta
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1394648.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 14:43:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	28 shtator 2026, 14:30:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 28 shtator 2026, 14:29:00 UTC → 28 shtator 2026, 14:31:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9c036ffe5e720fd506e2b341397c4b2bae60d505f98b7a99163f6fc3a2ba5f88
TEKSTI	f2715874be9579087c302a53c1b46557f0cbf2926853abddde905717225960197
PAMJA	6b58a2d49f29dbd46dbf17437e01a4c26c900000764fe9c30c788da8e693dfa7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1802ab17f547fe4667b245de3642ce010635c8d5da766135c2401319bf7723de
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	70759019bbdb922600e92acf251987d45dad965704b935fe53775a49569cfd8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1802ab17f547fe4667b245de3642ce010635c8d5da766135c2401319bf7723de>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Dëbimi i pestë nga Britania, shqiptari kërkon azil: Në Shqipëri më rrezikohet jeta

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 28.09.2026, 16:30



Share



Share



Një shtetas shqiptar me një histori të gjatë dënimesh për vjedhje në Britaninë e Madhe ka nisur një tjetër betejë ligjore për të shmangur dëbimin drejt Shqipërisë, duke pretenduar se kthimi në vendlindje i rrezikon jetën.

30-vjeçari, i cili sipas raportimeve të mediave britanike është dëbuar katër herë më parë nga Home Office dhe më pas është rikthyer ilegalisht në Britani, po kundërshton tashmë urdhrin e pestë të dëbimit. Ai ka paraqitur gjithashtu një kërkesë për azil, duke pretenduar se është i kërcënuar nga një grup kriminal shqiptar.

Çështja u shqyrtua në Taylor House Immigration Tribunal Centre në Londër. Gjatë seancës, shqiptari deklaroi se kishte zgjedhur të rikthehej në Britani pasi besonte se ishte shumë më e vështirë për personat që, sipas tij, e kërcënonin, ta gjenin atje.

Sipas dëshmisë së tij, ai kishte mbërritur për herë të parë në Britani kur ishte vetëm 13 vjeç. Më vonë, pretendoi se kishte rënë nën kontrollin e një grupi kriminal shqiptar, i cili e kishte detyruar të kryente vjedhje. Ai tha se problemet nisën të rëndoheshin pasi u përpoq të shkëputej prej tyre dhe se kërcënimet prekën edhe familjen e tij.

Shqiptari pretendoi se, sa herë që kthehej në Shqipëri pas dëbimit, merrte vesh se grupi po e kërkonte. Për këtë arsye, sipas tij, ai largohej përsëri pas vetëm dy ose tre javësh. Ai tha se kishte provuar edhe të qëndronte në shtete të tjera europiane, por edhe atje ishte zbuluar.

"Grupi ka qenë në kontakt në Shqipëri. Më kanë rrëmbyer dhe një herë më kanë vendosur thikën në fyt. Pata fat që shpëtova. U përpoqa të qëndroja në Europë, por atje ishte shumë e lehtë të më gjenin, kështu që duhej të vija këtu", deklaroi ai gjatë procesit.

Ai përmendi gjithashtu një konflikt të pretenduar familjar në Shqipëri, duke thënë se familja e tij ishte përfshirë në një gjakmarrje. Sipas dëshmisë së tij, një xhaxha ishte qëlluar rreth dy vite më parë, ndërsa policia lokale, të cilën ai e akuzoi për korrupsion, nuk kishte vijuar hetimet.

Pretendimet u kundërshtuan nga përfaqësuesja e Home Office, Khdeej Khan. Ajo argumentoi se nuk ishin paraqitur prova që të vërtetonin se shqiptari përballej me një rrezik real në Shqipëri. Gjithashtu, ajo vuri në dukje se ai nuk kishte denoncuar në polici kërcënimet që pretendonte se kishte marrë.

Shqiptari u përgjigj se arsyeja përse nuk kishte kërkuar ndihmë nga autoritetet shqiptare ishte, sipas tij, frika se policia ishte e korruptuar dhe se grupi kriminal kishte lidhje me persona brenda strukturave shtetërore.

Në seancë u diskutua edhe e kaluara e tij kriminale në Britani. Përfaqësuesja e Home Office e pyeti nëse prante se kishte kryer në mënyrë të përsëritur vjedhje dhe kishte shkelur ligjet e emigracionit duke u kthyer në Britani pas dëbimeve.

30-vjeçari pranoi se veprat e kryera prej tij ishin "shumë të rënda", por këmbënguli se rikthimet ilegale ishin të lidhura me frikën në jetën e tij.



Më të Lexuarat



Albanian Media Ethics Association

ARTIKULL JOETIK?

konfirmuar se kishin regjistruar informata me anë të rrjetit të tyre.

Një tjetër element i diskutuar gjatë seancës ishte aktiviteti i tij në rrjetet sociale. Përfaqësuesja e Home Office ngriti pikëpyetje për publikimet e shpeshta të shqiptarit, ku shfaqej me makina luksoze dhe në ambiente nate. Sipas saj, kjo sjellje ngre pikëpyetje për pretendimin se ai kishte frikë se mund të gjendej nga personat që e kërcënonin.

Ai deklaroi se në Britani “ndihet i sigurt”, por pranoi se publikimet në rrjetet sociale mund të shihen nga persona në çdo pjesë të botës.

Debati për anonimitetin

Gjatë procesit, gjykata kishte vendosur që identiteti i shqiptarit të mos bëhej publik. Avokati i tij, Eric Fripp, argumentoi se anonimiteti ishte i nevojshëm pasi klienti i tij po kërkonte mbrojtje ndërkombëtare për shkak të rrezikut të pretenduar në Shqipëri.

Kërkesa u pranua nga gjyqtarja Ravinder Bagral.

Megjithatë, sipas Daily Mail, në të njëjtën ditë me seancën, shqiptari publikoi në rrjetet sociale një video që dukej se ishte filmuar brenda ambienteve të gjykatës. Në përshkrimin e videos ai kishte përmendur edhe emrin e gjykatës.

Kjo ngriti pikëpyetje të tjera, pasi fotografimi dhe filmimi brenda godinave të gjykatave britanike është i kufizuar dhe shkelja e rregullave mund të trajtohet si shpërfillje e gjykatës.

Daily Mail ka kërkuar heqjen e urdhrit të anonimitetit. Një përfaqësues i gjykatës konfirmoi pas seancës së 15 shtatorit se kërkesa ishte marrë dhe po shqyrtohej.

Vendimi për anonimitetin u kritikua edhe nga Alan Mendoza, drejtor ekzekutiv i Henry Jackson Society, i cili argumentoi se parimi i drejtësisë së hapur kërkon që publiku të ketë mundësi të shohë se si merren vendimet gjyqësore.

Sipas tij, rasti ishte veçanërisht problematik pasi shqiptari, ndërsa përballej me dëbimin e pestë, kishte publikuar vetë pamje që dukej se tregonin vendndodhjen e tij në gjykatë.

Ndërkohë, shqiptari ka një fëmijë në Britani me ish-partneren. Gjatë procesit ai pretendoi gjithashtu se raportimet e mëparshme mediatike për çështjen e tij kishin ndikuar në gjendjen e tij psikologjike.

Çështja mbetet ende e hapur dhe vendimi përfundimtar pritet të merret nga gjyqtarja Ravinder Bagral.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!


Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.